



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1207/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Qamil Ajeti, kandidat për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AAK-LDD në Viti, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të manipulimit me vota, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Qamil Ajeti kandidat për anëtar të kuvendit komunal në Viti, nga radhët koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë (AAK-LDD).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 03.12.2013 në ora 15:16 nga Qamil Ajeti kandidat për anëtar të kuvendit komunal, duke pretenduar se në vendvotimin 2609D-02R janë bërë parregullsi pasi që në FPR kanë qenë 190 vota ndërsa në KQZ kanë qenë 163 vota dhe më është bërë padrejtësi, thuhet në ankesë. Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi.

PZAP-i, pasi që ankesën gjeti se:

ankesa është e pabazuar

PZAP-i, pasi që shqyrtoi ankesën e kandidatit Qamil Ajeti për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e AAK-LDD-së, konstatoi se pretendimet ankimore nuk janë të argumentuara në fakte konkrete dhe dëshmi, pasi që ankuesi në fjalë nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi me qëllim të vërtetimit të shkeljes së supozuar. Andaj, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, ankesa vlerësohet si e pa bazë, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa

Anr. 1207/2013 më datën 06.12.2013.



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.